EMRI/ Lëvizte me pistoletë, gati për qitje, pranga 44-vjeçarit në Tiranë. I sekuestrohet ID e falsifikuar, para dhe drogë

22 Gusht, 2023 12:51

Madhësia e tekstit:

Policia e Tiranës ka arrestuar në flagrancë 44-vjeçarin, Niko Begaj, i cili lëvizje me armë zjarri pistoletë me fishek fole, gati për qitje.

Gjatë kontrolleve, policia sekuestroi armën e zjarrit, municion luftarak, një mjet identifikimi i dyshuar i falsifikuar, 6230 euro, si dhe sasi lënde e dyshuar narkotike, kokainë.

Njoftimi i policisë:

Finalizohet nga Sektori i Forcës së Posaçme "Shqiponja" dhe Komisariati i Policisë Nr. 3, operacioni policor i koduar "Walker".

Lëvizte me armë zjarri pistoletë me fishek në fole, gati për qitje, arrestohet në flagrancë 44-vjeçari.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë, municioni luftarak, një mjet identifikimi i dyshuar i falsifikuar, 6230 euro, si dhe sasi lënde e dyshuar narkotike kokainë, që iu gjetën 44-vjeçarit, gjatë kontrollit fizik.

Shërbimet e Sektorit të Forcës së Posaçme "Shqiponja", në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 3, në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruara përmes inteligjencës policore për një shtetas që lëvizte i armatosur në Rrugën e Barrikadave, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Walker".

Si rezultat i këtij operacioni u arrestua në flagrancë shtetasi N. B., 44 vjeç, banues në Vlorë.

Gjatë operacionit, në Rrugën e Barrikadave, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar dhe ndaluar shtetasin N. B. Gjatë kontrollit fizik, atij i janë gjetur dhe sekuestruar, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë me fishek në fole gati për qitje, me krehër dhe municion luftarak, një mjet identifikimi i dyshuar i falsifikuar, 6230 euro, si dhe sasi lënde e dyshuar narkotike kokainë.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

Pep Guardiola kryen ndërhyrje kirurgjikale, Manchester City humb trajnerin për dy ndeshje
22 Gusht, 2023

Balla përkujton 30-vjetorin e rënies në detyrë të efektivit të RENEAS, Arben Ujka: ZERO tolerancë për këdo që nuk i bindet urdhrit ligjshëm të policit
Klodiana Lala | 22 Gusht, 2023

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Shkoi të rrëmbente vajzën që donte, pasi familja nuk pranoi zbrazi kallashnikovin drejt banesës, zbardhen detaje nga ngjarja në Skrapar
Eneida Petova | 22 Gusht, 2023

Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata
22 Gusht, 2023

"Çmendet" 34-vjeçari, qëllon me kallashnikov një banesë dhe i rrezikon jetën një familjeje, arrestohet
22 Gusht, 2023

EMRAT/ Goditi me sende të forta një burrë dhe një grua në Delvinë, shpallet në kërkim 32-vjeçari
22 Gusht, 2023

"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, eksperti rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...
22 Gusht, 2023

Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari: Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja
22 Gusht, 2023

KATEGORIA VIDEO

Koncesioni i sterilizimit/ "Asgjë nuk është bërë pa bekimin e Ramës dhe Beqiajt", Vokshi: Ish-ministri kërkon të kapet pas fijes së kashtës, por...
22 Gusht, 2023

Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata
22 Gusht, 2023

"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, eksperti rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...
22 Gusht, 2023

Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari: Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja
22 Gusht, 2023

Gjeste të pahijshme në tribunë, thellohet skandali rreth Rubiales, vjen dhe denoncimi i parë
22 Gusht, 2023

Nga "Rruga e Kosovarëve" fluturon mbi digë, Velaj publikon videon e aksidentit: Dënimin maksimal për shoferin!
22 Gusht, 2023

LAJMET E FUNDIT

Pep Guardiola kryen ndërhyrje kirurgjikale, Manchester City humb trajnerin për dy ndeshje
22 Gusht, 2023

Balla përkujton 30-vjetorin e rënies në detyrë të efektivit të RENEAS, Arben Ujka: ZERO tolerancë për këdo që nuk i bindet urdhrit ligjshëm të policit
Klodiana Lala | 22 Gusht, 2023

Shkoi të rrëmbente vajzën që donte, pasi familja nuk pranoi zbrazi kallashnikovin drejt banesës, zbardhen detaje nga ngjarja në Skrapar
Eneida Petova | 22 Gusht, 2023

Koncesioni i sterilizimit/ "Asgjë nuk është bërë pa bekimin e Ramës dhe Beqiajt", Vokshi: Ish-ministri kërkon të kapet pas fijes së kashtës, por...
22 Gusht, 2023

Tragjike në Greqi, gjenden të djegur 18 trupa në një pyll në pjesën veriore të vendit
22 Gusht, 2023

Mbappe në "ankand" deri në orët e fundit të merkatos, Real Madrid me plan djallëzor, por rrezikon...
22 Gusht, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.